



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 118/3 Prot.

Tiranë, më 02. 03. 2026

V E N D I M

Nr. 50, datë 02. 03. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën nr. 300, datë 27.11.2025, paraqitur nga Shoqata “Për Drejtësi Sociale” (*në vijim pala ankuese*), kundër Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), me pretendimin për diskriminim, për shkak të racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, pamjes së jashtëm dhe përkatësisë në një grup të veçantë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar ndër të tjera se: “*Në përputhje me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Shoqata “Drejtësi Sociale”, me shqetësim të thellë për përdorimin e gjuhës publike që cenon dinjitetin dhe promovon paragjykimet racore, paraqet këtë ankesë zyrtare ndaj emisionit “Super Gol” të transmetuar në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH), ku ndërkohë që në ekran shfaqej një futbollist me ngjyrë, pjesë e ekipit të Burrelit, në studio dëgjoheshin të qeshura, batuta dhe komente fyese lidhur me ngjyrën e lëkurës dhe pamjen e tij fizike, të bëra nga moderatorja dhe të ftuarit. Këto veprime përbëjnë një formë të qartë të racizmit dhe bullizmit publik, të cilat tentojnë të justifikohen si “humor” apo “batutë”, por në përmbajtje nxisin përçmim dhe paragjykim racor, duke cenuar dinjitetin e individit dhe duke kontribuar në normalizimin e gjuhës së urrejtjes në hapësirën publike.*

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Ky rast përbën shkelje të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të Kodit të Etikës së Medias dhe të nenit 18 të Kushtetutës, duke përfshirë ndalimin e çdo forme diskriminimi për shkak të racës, ngjyrës, origjinës etnike apo kombëtare, si dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

Racizmi i shfaqur në ekran është vetëm simptomë e një fenomeni më të gjerë: përmes punës në terren, Shoqata Drejtësi Sociale ka konstatuar vazhdimisht se shtetas afrikanë që jetojnë dhe punojnë në Shqipëri përballen me racizëm të përditshëm, shfrytëzim ekonomik, izolim social, mbajtje peng përmes marrjes së pasaportave nga punëdhënësit dhe mungesë reagimi nga institucionet, duke e bërë këtë një problem strukturor që tejkalon incidentin individual...

Për këtë arsye, Shoqata “Për Drejtësi Sociale” kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që të nisë hetim mbi rastin, të konstatojë shkeljen e ligjit dhe të kërkojë masa ndaj RTSH-së, duke përfshirë faljen publike ndaj futbollistit të përfshirë, ndërgjegjësim dhe trajnime për stafin e televizionit, si dhe publikimin e një deklaratë përfundimtare për të sensibilizuar publikun dhe për të parandaluar raste të ngjashme në të ardhmen.

Racizmi nuk është humor: ai është një formë dhune simbolike që cenon dinjitetin, ushqen paragjykimet dhe dëmton kohezionin shoqëror, dhe Komisioneri duhet të ndërhyjë menjëherë për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe respektimin e standardeve të barazisë racore.”

Për këtë arsye, Shoqata “Për Drejtësi Sociale” kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- 1. Të trajtojë episodin e transmetuar në emisionin “Super Gol” si një formë të qartë të diskriminimit racor publik dhe institucional.*
- 2. Të kërkojë nga RTSH dhe moderatorët e përfshirë një falje publike për gjuhën fyese dhe përqeshëse të përdorur gjatë transmetimit.*
- 3. Të urdhërojë RTSH që të heqë menjëherë përmbajtjen e episodit nga të gjitha platformat e transmetimit dhe arkivat publike, duke parandaluar shpërndarjen e mëtejshme të materialit racist.*
- 4. Të kërkojë nga RTSH që të prodhojë dhe transmetojë një spot publik ndërgjegjëses kundër racizmit dhe gjuhës së urrejtjes, i cili të promovojë barazinë, respektin dhe diversitetin në shoqëri.*
- 5. Të kërkojë nga RTSH ose të rekomandojë hartimin e një rregulloreje të brendshme kundër racizmit dhe gjuhës diskriminuese që të zbatohet në të gjitha programet, stafin dhe përmbajtjet e transmetuara, si dhe të shërbejë si model për institucionet e tjera publike.*
- 6. Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore dhe administrative për të garantuar që institucionet dhe figurat publike të mbahen përgjegjëse për gjuhën që përdorin në komunikimet zyrtare dhe publike.*

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund ta bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”.*

Nga aktet e administruara rezulton se, Shoqata “Për Drejtësi Sociale” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me Vendimin nr. 6599, datë 14.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Shoqata “Për Drejtësi Sociale” pretendon përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe promovimin e paragjyqimeve racore gjatë transmetimit të emisionit “Super Gol” në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH).

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Shoqata “Për Drejtësi Sociale”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’ju përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë shtetasit që i përkasin pakicave rome dhe pakicave egjiptiane, emigrantët etj.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas analizimit paraparak të ankesës nr. 300 Regj., datë 27.11.2025, që i përket ankuesit Shoqatës “Për Drejtësi Sociale” kundër Radio Televizionit Shqiptar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1680/1 prot., datë 04.12.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Radio Televizioni Shqiptar, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje sa më sipër, me shkresën³ nr. 2814/1 prot., datë 12.12.2025, RTSH sqaroi Komisionerin ndër të tjera se: “Në datën 09.11.2025 gjatë transmetimit të emisionit “Super Gol” Moderatorja e RTSH-së ka treguar mungesë etike dhe profesionale gjatë intervistës së një futbollisti me ngjyrë të ekipit të Burrelit. Mbështetur në këto konstatime, Drejtori i Përgjithshëm ka marrë vendimin nr. 579, datë 12.11.2025 “Për dhënie mase disiplinore” ndaj moderatores.

Por pavarësisht rastit të veçuar dhe perceptimit që ky episod ka krijuar, theksojmë se RTSH-ja gjatë veprimtarisë së saj vepron në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 10 221/ 2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Radio Televizioni Shqiptar në respektim të çdo detyrimi ligjor ka ndërmarrë një sërë masash për rastin duke hequr episodin nga platformat e transmetimit dhe arkivat publike.

RTSH-ja ka qartësuar dhe shpjeguar në programet e saj televizive rastin duke kërkuar edhe ndjesë publike në rast prekje apo shkelje të padëshiruar të ndonjë individi apo grupimi të caktuar. Në të gjitha aktet rregullative të RTSH-së, përfshirë Kodin e Sjelljes dhe Etikës (por jo vetëm) sanksionohet mbrojtja e punonjësve dhe palëve të treta nga çdo lloj diskriminimi. Parimet editoriale të RTSH-së kanë bazë të tyre zbatimin e parimit të diskriminimit, i cili është detyrues për çdo moderator dhe jo vetëm.

Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm dhe atë në vijim, garantojmë ruajtjen e standardit në mbrojtje të çdo pale ndaj diskriminimit të çdo lloji qoftë”.

2. Me e-mail-in datë 19.12.2025, Komisioneri i përcolli subjektit ankues, Shoqatës “Për Drejtësi Sociale”, përgjigjen e vënë në dispozicion nga ana e RTSH-së.
3. Përmes shkresës nr. 118 prot., datë 13.01.2026, Komisioneri iu drejtua sërish RTSH-së duke i kërkuar ndër të tjera sa më poshtë vijon:
 - Kopje të vendimit nr. 579, datë 12.11.2025 “Për dhënie mase disiplinore”, të dhënë ndaj moderatores nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

³ Administruar pranë Komisionerit me nr. 1680/2 prot., datë 17.12.2025.

- Kopje në CD, të programin apo programeve televizive të transmetuara në RTSH, në të cilat është kërkuar ndjesë publike lidhur me situatën e ndodhur në datën 09.11.2025 gjatë transmetimit të emisionit “*Super Gol*”.
- Dokumentacion provues, sa i përket akteve të RTSH-së në të cilat është sanksionuar mbrojtja e punonjësve dhe palëve të treta nga çdo lloj sjellje diskriminuese.

Në përgjigje sa më sipër, me shkresën⁴ nr. 118/2 prot., datë 28.01.2026, RTSH vuri në dispozicion të Komisionerit dokumentacionin dhe informacionin si më poshtë:

- Kopje të Vendimit nr. 579, datë 12.11.2025, “Për dhënien e masës disiplinore”, dhënë ndaj moderatores nga Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar;
- Kopje të CD-së së programit televiziv të transmetuar nga Radio Televizioni Shqiptar, në të cilin është kërkuar ndjesë publike lidhur me situatën e ndodhur në datën 09.11.2025, gjatë transmetimit të emisionit “*Super Gol*”;
- Dokumentacion provues në lidhje me aktet e Radio Televizionit Shqiptar, në të cilat është sanksionuar mbrojtja e punonjësve dhe e palëve të treta nga çdo formë sjelljeje diskriminuese, konkretisht:
 - “*Kodi i Sjelljes dhe Etikës në Radio Televizionin Shqiptar*”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të RTSH-së nr. 48, datë 06.11.2025.

4. Përmes e-mail-it datë 24.02.2026, pala ankuese i ka kthyer përgjigje Komisionerit, ku informon ndër të tjera se: “*Duke ju falënderuar për trajtimin e ankesës kundrejt RTSH-së, shprehemi se jemi dakord me masën e marrë nga RTSH-ja ndaj gazetares. Gjithsesi, nëse nga ana juaj mendohet të shkoj më tej si hetim dhe ti rekomandohet RTSH-së hartimin e një rregullore për parandalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga drejtuesit e emisioneve dhe të ftuarve, do ishte ideale.*”

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

“*a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr. 118/2 prot., datë 28.01.2026.

- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra nga ana e Radio Televizionit Shqiptar, përmes dhënies së masës disiplinore moderatores së emisionit “*Super Gol*” dhe ndjesës publike kërkuar në emisionin “*Në kohë reale*”, datë 12.11.2025;
- Përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete;
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin e ndërmjetësimin për zgjidhje miqësore e zbatim efektiv të tij, dhe jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimmarrjeve të KMD-së;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 300 Regj., datë 27.11.2025, të Shoqatës “*Për Drejtësi Sociale*” kundër Radio Televizionit Shqiptar, duhet të deklarohej e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur⁵.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 300, datë 27.11.2025, paraqitur nga Shoqatës “*Për Drejtësi Sociale*”, kundër Radio Televizionit Shqiptar, pa një vendim përfundimtar pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura administrative.
2. Me qëllim parandalimin e situatave të tilla si në rastin konkret dhe sjelljeve diskriminuese gjatë programeve televizive, rekomandohet që Radio Televizioni Shqiptar, të marrë masa për të parashikuar një rregullore për parandalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë transmetimit të tyre, nga drejtuesit e emisioneve dhe një kopje të tyre t’i bëhet me dije të ftuarve përpara daljes në to.

⁵ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 3, datë 06.01.2025 dhe Nr. 240, datë 20.10.2025.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, pamjes së jashtëm dhe përkatësisë në një grup të veçantë)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)